



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
TREGUN ME PAKICË TË LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË SË RSH-SË**

Miratuar me vendimin e Bordit nr.22, datë 26.03.2009

Ndryshuar me vendimin e Bordit nr.79, datë 28.08.2009

Kjo Rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14 pika 3, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe të nenit 78 paragrafi i tretë të Ligjit nr.9879 datë 21.2.2008 “Për Titujt”.

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje, është përcaktimi i rregullave për funksionimin dhe mbikëqyrjen e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, ku përfshihen: bono thesari dhe obligacione.

**Neni 2
Tregu me pakicë i letrave me vlerë te Qeverisë**

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është një nga format e tregjeve të rregulluara dhe mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është tregu i organizuar në sportelet fizike apo virtuale të bankave dhe subjekteve të tjera të licencuara, për kryerjen e transaksioneve në letrat me vlerë të Qeverisë, me investitorët, të cilët mund të jenë, persona fizikë ose juridikë, rezidente dhe jorezidente.

Asnjë bankë apo subjekt tjetër nuk mund të kryejë tregtim me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë pa u licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Tregtimi i letrave me vlerë të Qeverisë në tregun ndërbankar nuk është objekt i kësaj rregulloreje.

Neni 3

Llojet e transaksioneve në tregun me pakicë

Transaksionet që mund të kryhen nga bankat dhe subjektet e tjera të licencuara në tregun me pakicë janë:

- a) Blerje e letrave me vlerë të Qeverisë në tregun primar (ankand) nga investitori nëpërmjet bankës, apo subjektit të licencuar;
- b) Shitja e letrave me vlerë të Qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo subjektit të licencuar;
- c) Blerja e letrave me vlerë të Qeverisë nga banka apo subjekti i licencuar para datës së maturimit nga çdo investitor; pavarësisht nëse veprimet e mëparshme nuk janë kryer nga e njëjta bankë apo subjekt i licencuar;
- d) Vendosja e letrave me vlerë të Qeverisë si kolateral;
- e) Shlyerja e vlerës nominale në datën e maturimit.

Neni 4

Emetuesi

Letrat me vlerë tregtohen sipas kushteve të përcaktuara nga emetuesi.

Neni 5

Metoda e llogaritjes së çmimit

Banka apo subjekti i licencuar përdor të njëjtën metodë llogaritje si për çmimin e blerjes, ashtu dhe për atë të shitjes, me bazë vjetore 365 ditë për transaksionet me bono thesari.

Neni 6

Dokumentacioni vërtetues

Banka apo subjekti i licencuar që shet bono thesari në tregun me pakicë, pajis blerësin:

- a) me një vërtetim për shpallje fitues për veprimet e tregut primar
- b) me një vërtetim blerje për veprimet e shitjes nga portofoli i vet

Vërtetimi duhet të përmbajë të paktën emrin dhe adresën e investitorit, datën e transaksionit dhe datën e kryerjes së veprimit, vlerën nominale të bonos të blerë, Yield-in, çmimin e skontuar dhe mënyrën e pagesës në maturim, sipas modelit bashkëlidhur Aneksit 2 të kësaj rregulloreje.

Banka apo subjekti i licencuar që shet obligacione në tregun me pakicë, pajis blerësin me një vërtetim blerje për veprimet e shitjes nga portofoli i vet. Vërtetimi për obligacionet duhet të përmbajë të paktën emrin dhe adresën e investitorit, datën e transaksionit dhe datën e kryerjes së veprimit, vlerën nominale të obligacionit, çmimin e shitjes, vlerën e kuponit të ofruar, yield uniform i pranuar, shpeshhtësinë e pagesës së kuponit, datën e

pagimit të kuponit dhe mënyrën e pagesës në maturim, sipas modelit bashkëlidhur Aneksit 2 të kësaj rregulloreje.

Investitori mund ti kërkojë bankës apo ndonjë subjekti tjetër të licencuar ta pajisë me një njoftim mbi lëvizjet e llogarisë së tij sipas të dhënave të sistemit të ruajtjes dhe mbajtjes së letrave me vlerë të Qeverisë.

Neni 7

Sistemi i mbajtjes dhe ruajtjes së letrave me vlerë të Qeverisë

Të dhënat mbi transaksionet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë administrohen nga bankat e autorizuar për kryerjen e veprimtarisë së kujdestarisë së letrave me vlerë të Qeverisë sipas Rregullores “Për kushtet e autorizimit të kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë”, miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Ky sistem, siguron mbajtjen e të dhënave në mënyrë të detajuar për investitorët mbi pronësinë e letrave me vlerë të Qeverisë, transaksionet e kryera në lidhje me këto letra me vlerë apo të dhëna në lidhje me vendosjen e tyre si garanci.

Bankat apo subjektet e tjera të licencuara për kryerje transaksionesh në tregun me pakicë, duhet të sigurojnë mbajtjen e të gjitha të dhënave sipas paragrafit të parë dhe të dytë të këtij neni në një bankë të autorizuar si kujdestar bazuar në një marrëveshje midis tyre.

Sigurimi i mbajtjes dhe ruajtjes së letrave me vlerë të Qeverisë analitik sipas këtij neni, përbën kusht për licencimin e bankës apo çdo subjektit për kryerjen e transaksioneve në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

Neni 8

Detyrimi për kleringun dhe rregullimin e llogarive

Në rastin e blerjes së letrave me vlerë të Qeverisë para datës së maturimit nga banka apo subjekti i licencuar, kur transaksioni nuk është kryer nga e njëjta bankë apo subjekt i licencuar, kujdestari i blerësit detyrohet të japë konfirmimin mbi gjendjen e llogarisë në letra me vlerë palës në transaksion.

Në rast të ekzekutimit të transaksionit, kujdestari, me të marrë njoftimin nga pala tjetër në transaksion, është i detyruar të njoftojnë menjëherë Bankën e Shqipërisë për kleringun dhe rregullimin e llogarive në regjistrin sintetik, sipas rregulloreve të miratuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 9

Detyrimi për informim të investitorit

Bankat apo subjektet e tjera të licencuara janë të detyruara të informojnë publikun për të dhënat mbi letrat me vlerë të Qeverisë të ofruara, çmimin e shitjes dhe të blerjes, llojet e transaksioneve, yield-et, kuponin dhe komisionet që aplikohen, nëpërmjet publikimit në sistemin elektronik GSRM sipas mënyrës së parashikuar në Aneksin 3, bashkëngjitur. Këto të dhëna në mënyrë të sintetizuar publikohen edhe në një vend të dukshëm në sportelet e subjekteve dhe forma të tjera komunikimi.

Neni 10

Raportimi dhe Monitorimi

Bankat apo subjektet e tjera të licencuara, pasi të kenë rakorduar të dhënat me Bankën e Shqipërisë, raportojnë në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për aktivitetin e kryer gjatë çdo muaji në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë brenda javës së parë të muajit pasardhës, me të dhënat sipas aneksit 1 bashkëngjitur.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare monitoron në mënyrë të vazhdueshme ecurinë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë nëpërmjet raportimit të të dhënave dhe inspektimit në vend të ecurisë së procesit.

Neni 11

Referenca

Përcaktimet dhe procedurat e parashikuara në këtë rregullore i referohen marrëveshjes midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë “Mbi emetimin e bonove të thesarit në formë regjistrimi” dhe marrëveshjes “Mbi emetimin e obligacioneve në formë regjistri”.

Neni 12

Dispozitë tranzitore

Për bankat e licencuara më parë si regjistruar të letrave me vlerë të Qeverisë, zbatohen dispozitat e rregullores “Për kushtet e autorizimit të Kujdestarit të letrave me vlerë të Qeverisë”.

Banka e cila brenda dymbëdhjetë muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore, nuk plotëson kushtet për pajisjen me autorizim si kujdestar i letrave me vlerë të Qeverisë, duhet që brenda një muaji të marrë masa për transferimin e të gjitha të dhënave në një kujdestar të autorizuar.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Elisabeta GJONI
KRYETAR

Aneksi 1

Mbi raportimin mujor “Per Tregun me Pakice te Letrave me Vlere te Qeverise”

Banka _____
Data raportimit _____
Periudha raportuese _____

Transaksione ne Tregun me Pakice te Bonove te Thesarit*

Lloji i transaksionit	Bono 3-mujore**		Bono 6-mujore		Bono 12-mujore	
	Vlera nominale	Nr transak	Vlera Nominale	Nr transak	Vlera nominale	Nr transak
Blerje ne tregun primar						
Shitje nga portofoli i bankes apo subjektit te licensuar						
Blerje e bonove nga banka/ subjekti i licensuar para maturimit						
Shlyerja e vleres nominale ne maturim						
Bono e vendosur si kolateral						

Transaksione ne Tregun me Pakice te Obligacioneve te Qeverise*

Lloji i transaksionit	Obligac. 2-vjecare			Oblig. 3-vjecare			Oblig. 5-vjecare		
	Vl.nom	Nr.	Kup	Vl.nom	Nr.	Kup	Vl.nom	Nr.	Kup
Shitje nga portofoli i bankes/subjekt te licens									
Blerje e oblig nga banka/ subjekti i licens para maturimit									
Shlyerja e vleres nominale ne maturim									
Obligacion vendosur si kolateral									

* Pasqyrat plotesohen veç per individet dhe veç per personat juridike. Per personat juridike te tregohet e ndare per rezidente dhe jorezidente.

** Te identifikohet transaksioni nga lloji i letres me vlere sipas emetimit, pavaresisht nga ditet e mbetura ne maturim te bonos/obligacionit.

Nenshkrimi
Drejtuesi i Kujdestarit

Kerkesat baze te Vertetimit qe leshon Banka/Subjekti i licensuar mbi llojin e transaksionit te kryer ne Tregun me pakice te Bonove te Thesarit/obligacioneve

➤ **Te pergjithshme**

- Stema e Bankes/subjektit te licensuar qe leshon vertetimin
- Data e leshimit te vertetimit
- Nenshkrimi nga firma e autorizuar

➤ **Te dhena mbi klientin**

- Emri, Atesia, Mbiemri
- Adresa
- Nr. i identifikimit , Kodi i identifikimit te klientit (nese ka)
- Llogaria bankare

➤ **Te dhena mbi transaksionin ne tregun me pakice**

(plotesimi I cdo pike te meposhte sipas llojit te transaksionit)

▪ **Lloji I transaksionit**

- *Blerje e bonove ne tregun primar*
- *Shitje nga portofoli i bankes te letres me vlere te qeverise*
- *Blerje e bonove/obligacioneve nga Banka/subjekti i licensuar para maturimit*
- *Shlyerja e vleres nominale ne maturim*
- *Bono/obligacion e vendosur si kolateral*

▪ **Data e kontrates (e kryerjes se transaksionit)**

▪ **Date valuta (e berjes efektive)**

▪ **Te dhena mbi bonon e thesarit/obligacionin**

- Emertimi ose Kodi i bonos se thesarit/obligacionit (nese ka)
- Nr. i ankandit
- Data e emetimit
- Data e maturimit
- Nr. i diteve te bonos/obligacionit deri ne maturim
- Vlera nominale
- Prorate
- Cmimi i blerjes
- Cmimi i shitjes
- Yield i bonos/obligacionit
- Kuponi i percaktuar/i llogaritur
- Shpeshtesia e pagimit te kuponit
- Menyra e pagimit te kuponit

➤ **Te dhena te tjera**

- Tatimi mbi interesin
- Komisioni apo pagesa te tjera

➤ **Informacin mbi Bonot e Thesarit/obligacionet**

** Sugjerojme qe keto çeshtje te shenohen ne pjesen e prapme te Vertetimit, sipas formulimit te dhene ne faqen 2 te ketij aneksi (opsionale), ose ne rast te vendoset ne formen e shenimit disa fjali-informacion, ne fund te faqes se Vertetimit.*

Aneksi 2

Faqja 2

- Stema e Ministrise se Financave

Informacion mbi Bonot e Thesarit

Te pergjithshme

Bonot e Thesarit jane letra me vlere te borxhit te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise, te perfaqesuar nga Ministria e Financave ne forme regjistrimi.

Bonot e Thesarit jane letra me vlere afatshkurter me afat maturirmi deri ne 1 vit. Aktualisht ne Shqiperi emetohen Bono Thesari me afati maturimit 3, 6 dhe 12 mujore.

Bonot e Thesarit shiten me zbritje ndaj vleres se tyre nominale. Diferenca mes cmimit te blerjes dhe vleres nominale perfaqeson interesin e fituar nga bonot. Investitori ne daten e blerjes paguan vetem cmimin e blerjes ne perputhje me vleren nominale dhe normen e zbritjes (Yield), qe percaktohet ne ankand.

Ne daten e maturimit, paguhet vlera nominale ose Bonot e Thesarit mund te riinvestohen.

Bonot e Thesarit emetohen ne forme regjistri ne llogari, qe do te thote se nuk kane nje forme fizike, por investitorit i jepet nje vertetim pronesie, apo vertetim per transaksionin qe ben me to. Regjistri i pronesise se bonove te Thesarit per individet mbahet prane Bankes se Shqiperise, apo nje Banke tjetere te licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare per kete qellim.

Emetimi i Bonove te Thesarit

Emetimi i Bonove te Thesarit behet nepermjet shitjes me ankand ne tregun primar te organizuara nga Banka e Shqiperise ne periudha kohe te rregullta.

Norma fillestare e emetimit:

Norma e zbritjes percaktohet nga ankandi

Vlera minimale per pjesmarrje ne ankand:

300.000 leke

Vlera maksimale:

-per pjesmarresit me kerkesa jokonkurrese 50 milion leke

-per kerkesa konkurrese 80% e shumes se ofruar ne ankand, pas pjesmarrjes se Bankes se Shqiperise.

Rritja e shumes se investuar ne bono:

Shumefishohet me 10.000 leke

Metoda e emetimit:

Ankandi nepermjet pjesmarrjes ne sportelet e bankave

Tregetimi i Bonove te Thesarit

Bonot e Thesarit jane lirisht te tregtueshme, ato mund te shiten dhe blihen para afatit te maturimit ne sportelet e bankave dhe subjekteve te tjera te licensuara.

Interesi i fituar nga Bonot terhiqet ne çdo kohe, duke filluar nga data e emetimit deri ne daten e maturimit.

Tatimi

Interesi nga bonot eshte objekt i tatimit mbi te ardhurat. Tatimi mbahet ne daten e maturimit.

Risku

Ministria e Financave eshte pergjegjese per sigurimin e likuiditetit te nevojshem.

- Stema e Ministrise se Financave

Informacion mbi obligacionet

Te pergjithshme

Obligacioni eshte leter me vlere e borxhit te emetuara nga Qeveria e Republikes se Shqiperise, te perfaqesuar nga Ministria e Financave ne forme regjistrimi.

Obligacioni eshte leter me vlere me afat maturirmi afatmesem dhe afatgjate duke filluar nga 1 vit deri ne disa dhjetra vjet. Aktualisht ne Shqiperi emetohen obligacione me afati maturimit 1, 2 dhe 5 vjet.

Obligacioni ofron nje interes vjetor, te quajtur kupon i percaktuar qe ne daten e emetimit. Kuponi paguhet cdo 6-muaj deri ne maturimin e obligacionit. Obligacionet shiten me cmimim me te larte, me te ulet ose me vlere nominale ne varesi te yield te tregut. Norma e kuponit e llogaritur mbi vleren nominale dhe diferenca mes cmimit te blerjes dhe vleres nominale perfaqeson te ardhurat e fituara nga obligacioni. Investitori ne daten e blerjes paguan vetem cmimin e blerjes ne perputhje me cmimin e percaktuar nga kushtet e tregut.

Ne daten e maturimit, paguhet vlera nominale.

Obligacionet emetohen ne forme regjistri ne llogari, qe do te thote se nuk kane nje forme fizike, por investitorit i jepet nje vertetim pronesie, apo vertetim per transaksionin qe ben me to. Regjistri i pronesise se obligacioneve per individet mbahet prane nje Banke apo subjekti tjetere te licensuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare per kete qellim.

Emetimi i Obligacioneve

Emetimi i Obligacioneve behet nepermjet shitjes me ankand ne tregun primar te organizuara nga Banka e Shqiperise ne periudha kohe te rregullta.

Tregetimi i Obligacioneve

Obligacionet jane lirisht te tregtueshme, ato mund te shiten dhe blihen para afatit te maturimit ne sportelet e bankave dhe subjekteve te tjera te licensuara.

Diferenca e cmimit me vleren nominale terhiqet ne cdo kohe, duke filluar nga data e emetimit deri ne daten e maturimit.

Tatimi

Interesi (kuponi) nga obligacionet eshte objekt i tatimit mbi te ardhurat.

Risku Ministria e Financave eshte pergjegjese per sigurimin e likuiditetit te nevojshem.

Aneksi 3

Mënyra e publikimit në kohë reale të të dhënave të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë në sistemin GSRM

1. Sistemi i kuotimit të të dhënave GSRM

- a) GSRM janë inicialet në gjuhën angleze të Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë (Government Securities Retail Market).
- b) Sistemi i kuotimit të të dhënave GSRM, është një sistem elektronik i raportimit dhe publikimit të të dhënave mbi kuotimet dhe transaksionet e ekzekutuara në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë;
- c) Në kuptim të kësaj rregulloreje: “kuotim” do të quhet publikimi nga bankat apo subjektet e licencuara i çmimit të blerjes dhe shitjes për çdo letër me vlerë që këto të fundit kuotojnë. “Transaksion i ekzekutuar” do të quhen të gjitha llojet e transaksioneve të parashikuara në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
- d) Të dhënat në lidhje me tregun primar të përdorura nga sistemi GSRM si: çmimi dhe data e emetimit, data e maturimit dhe kuponi (për obligacionet) në ditën e emetimit, do jenë të dhënat e realizuara në ankandet e tregut primar të letrave me vlerë të Qeverisë të organizuar nga Banka e Shqipërisë;
- e) Sistemi GSRM është një sistem elektronik i konceptuar dhe administruar nga Autoriteti. Ky sistem është i bazuar në internet (internet based);

2. Llojet e transaksioneve në tregun me pakicë

Transaksionet në letra me vlerë të Qeverisë që mund të kryhen në tregun me pakicë janë në përputhje me nenin 3 të kësaj rreguloreje. Në sistemin GSRM llojet e transaksioneve do kenë një kodifikim të tillë si vijon:

- ⌚ A - Blerje ne tregun primar
 - A1 – për personat fizikë (individët);
 - A2 - për personat juridikë

- ⌚ B- Shitja nga portofoli i bankes, apo subjektit te licensuar
 - B1 – për personat fizikë (individët);
 - B2 - për personat juridikë

- ⌚ C - Blerja nga banka apo subjekti i licensuar para dates se maturimit
 - C1 – për personat fizikë (individët);
 - C2 - për personat juridikë

- ⌚ D - Vendosja si kolateral
 - D1 – për personat fizikë (individët);
 - D2 - për personat juridikë

- ⌚ E - Shlyerja e vleres nominale ne daten e maturimit
 - E1 – për personat fizikë (individët);
 - E2 - për personat juridikë

3. Informacioni i Publikuar në sistemin GSRM

Bankat apo subjektet e licencuara janë të detyruara të publikojnë në kohë reale dhe çdo ditë në sistemin GSRM të dhëna që kanë lidhje me:

Për transaksionet e llojit B dhe C:

- a) çmimin e blerjes (%) të letrave me vlerë të Qeverisë,
- b) çmimin e shitjes (%) të letrave me vlerë të Qeverisë,
- c) vlerën e transaksionit (në Lek) në letrave me vlerë të Qeverisë,
- d) llojin e transaksionit.

Për transaksionet e llojit A, D dhe E:

- a) yield-in e transaksionit në letrave me vlerë të Qeverisë,
- b) numrin total të transaksioneve të ekzekutuara,
- c) vlerën totale të transaksioneve të ekzekutuara,
- d) llojin e transaksionit.

4. Karakteri informativ i të dhënave të publikuara në sistemin GSRM

Të dhënat e publikuara në sistemin GSRM kanë karakter “informues” dhe jo “detyrues”. Kjo do të thotë se bankat apo subjektet e licencuara ruajnë të drejtën për të negociuar me klientët e tyre për çmime të ndryshme nga çmimet e kuotuar prej tyre në sistemin GSRM.

5. Detyrimi i subjekteve mbi vërtetësinë e të dhënave për transaksionet e ekzekutuara

Bankat janë përgjegjëse për vërtetësinë e informacionit mbi transaksionet e ekzekutuara në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë.

6. Subjektet që publikojnë të dhëna në sistemin GSRM

- a) Në sistemin GSRM publikojnë të dhëna vetëm ato banka apo subjekte të licencuara nga Autoriteti për të ushtruar veprimtarinë si “tregtarë të letrave me vlerë të Qeverisë në tregun me pakicë”;
- b) Autoriteti nuk licencon individët që do të jenë përdorues të sistemit GSRM. Bankat dhe subjektet e licencuara caktojnë individë të veçantë për të publikuar të dhëna për llogari të tyre. Për këtë subjektet e licencuar njoftojnë Autoritetin, i cili u jep mundësinë këtyre përdoruesve të përdorin sistemin GSRM.

7. Koha e publikimit të të dhënave në sistemin GSRM

- a) Informacioni mbi kuotimet dhe transaksionet në letra me vlerë të Qeverisë në tregun me pakicë publikohet në sistemin GSRM çdo ditë pune nga ora 9.00 deri në orën 16.30;
- b) Çdo bankë apo subjekt i licencuar është i detyruar të kuotojë çdo ditë pas orës 9.00 çmimin e blerjes dhe të shitjes për letrat me vlerë që dëshiron të kuotojë në tregun me pakicë;
- c) Bankat dhe subjektet e licencuara publikojnë në sistemin GSRM çdo transaksion të realizuar në letra me vlerë të Qeverisë. Publikimi i të dhënave për transaksionet e llojit B dhe C bëhet menjëherë pas ekzekutimit të transaksionit mes subjektit të licencuar dhe klientit, ndërsa për transaksionet e llojit A, D dhe E, behët në fund të çdo dite.

8. Publikimi i të dhënave (futja e urdhrave) në sistemin GSRM dhe Autorizimi i përdoruesve

- a) Në sistemin GSRM mund të publikojnë të dhëna të gjithë personat e caktuar nga subjektet e licencuara dhe të autorizuar nga Autoriteti për futur të dhëna për llogari të subjekteve që përfaqësojnë;
- b) Autoriteti pajis me “kod” të veçantë çdo bankë apo subjekt të licencuar për të operuar në tregun me pakicë dhe për të publikuar të dhëna në sistemin GSRM. Kodi i çdo subjekti të licencuar duhet të jetë lehtësisht i dallueshëm nga subjektet e tjera dhe përbëhet nga shkronja;
- c) Çdo bankë apo subjekt i licencuar njofton me shkrim Autoritetin për çdo individ përdorues të sistemit për llogari të subjektit që përfaqëson;
- d) Autoriteti pajis me “emër përdoruesi” dhe “fjalëkalim” të veçantë çdo individ përdorues të sistemit GSRM. Emri i përdoruesit të çdo individi do të përbëhet nga shkronjat e subjektit që përfaqëson dhe nga shifra rendore si përdorues p.sh ABC01. Çdo subjekt i licencuar mund të ketë një numër të pakufizuar përdoruesish;
- e) Fjalëkalimi që i jepet çdo përdoruesi është fillestar dhe ndryshohet nga përdoruesi me qëllim ruajtjen e sigurisë;
- f) Autoriteti njofton me shkrim bankën apo subjektin e licencuar mbi “emrin e përdoruesit” dhe “fjalëkalimin fillestar” e çdo përdoruesi të caktuar prej tij;
- g) Autoriteti ruan në bazën e tij të të dhënave të gjithë informacionin e nevojshëm mbi çdo përdorues individual të sistemit GSRM dhe garanton për ruajtjen e konfidencialitetit dhe moskeqpërdorimin e këtyre të dhënave.

9. Gabimi në publikimin e të dhënave

- a) Në rast të një gabimi njerëzor apo dhënie informacioni të gabuar gjatë procesit të publikimit të të dhënave në sistemin GSRM, subjekti i licencuar njofton Autoritetin brenda 30 minutave me mjete elektronike (tel, faks ose e-mail);
- b) Në njoftim, subjekti i licencuar përfshin të gjitha detajet e nevojshme për identifikimin e gabimit në dhënie të informacionit;
- c) Me të marrë njoftim, Autoriteti merr masat e nevojshme për korrigjimin e gabimit,
- d) Nëse e konsideron të panevojshme dhe të papërshtatshme, Autoriteti ruan të drejtën e mosndryshimit të informacionit të publikuar.